

FEDERATA ATLETIKE E KOSOVËS

STATUTI
i
FEDERATËS ATLETIKE TË
KOSOVËS

Prishtinë, Shkurt, 2016

Në bazë të dokumentit Nr. 03/L-134 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe në bazë të nenit 27 të Ligjit për Sport të Kosovës, Kuvendi i Federatës Atletike të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 06.02.2016 aprovoi këtë:

STATUT TË FEDERATËS ATLETIKE TË KOSOVËS

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1.

Federata Atletike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: FAK) është asociacion sportiv i organizatave sportive të bashkuara, e organizuar për të nxitur zhvillimin dhe përparimin e sportit të atletikës në Republikën e Kosovës dhe arritjen e qëllimeve dhe interesave të tjera të përbashkëta, në përputhje me Ligjin e sportit (në tekstin e mëtejme Ligji) dhe këtë statut.

Neni 2.

Federata Atletike e Kosovës është themeluar në kuvendin themelues me 21 shtator të vitit 1991 në Prishtinë. Fushëveprimtaria e saj është në territorin e Republikës së Kosovës.

Federatën Atletike të Kosovës e përbëjnë të gjitha format e organizimit të aktiviteteve sportive amatore apo profesionale, organizatat sportive - klubet atletike dhe shoqatat profesionale (në tekstin e mëtejme anëtarët e Federatës), të cilët janë të organizuar dhe veprojnë në përputhje me Ligjin dhe këtë Statut.

Marrëdhëniet në FAK janë të bazuara në parimet e drejtësisë, barazisë dhe bashkësisë së organizatave sportive - të cekur në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 3.

Federata Atletike e Kosovës është anëtare e Komitetit Olimpik të Kosovës, Shoqatës Ndërkombëtare të Federatave Atletike (IAAF) dhe Shoqatës Evropiane të Atletikës (EAA), por mund të anëtarësohet edhe në shoqata tjera kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat janë në interes të sportit të atletikës në Kosovë.

Punën e saj FAK-u e orienton mbi bazën e respektimit të rregullave dhe rregulloreve të këtyre shoqatave.

Neni 4.

Federata Atletike e Kosovës funksionon si organizatë joprofitabile dhe jopolitike.

Neni 5.

Emri i Federatës është: Federata Atletike e Kosovës, kurse akronimi i saj është FAK. Selia e Federatës Atletike të Kosovës është në Prishtinë.

Neni 6.

Simboli i Federatës Atletike të Kosovës përbëhet prej rrethit në formë elipse i cili simbolizon shtegun e atletikës dhe shkurtesës së federatës – FAK të ngjyrës së kaltër të mbyllët dhe të bardhë, ku shkronja A në vete përmban simbolin e vrapuesit.

Flamuri i federatës atletike të Kosovës ka formën e katërkëndëshit, me dimensione 1:2, ngjyrë të bardhë me simbolin e federatës atletike të Kosovës në mes.

Neni 7.

Vula e Federatës atletike është e formës rrethore, me përmasa 38 mm.

Në rrethin e vulës është gdhendur – shkruar: Federata Atletike e Kosovës - Prishtinë, Kosovo Athletic Federation, ndërsa në mesin e vulës gjendet simboli i vrapuesit.

Vula protokollare është e formës së drejtkëndëshit e madhësisë 65 x 22 mm, me tekstin e shënuar Federata Atletike e Kosovës – Kosovo Athletic Federation në të cilën shënohet numri dhe data.

Neni 8.

Federata Atletike është person juridik, e regjistruar në regjistrin e organizatave sportive pran autoritetit kompetent të shtetit.

FAK operon një llogari bankare dhe për të gjitha detyrimet, përgjigjet me të gjitha mjetet e saj.

Federatën Atletike e përfaqëson dhe prezanton Kryetari si dhe Sekretari i Përgjithshëm, brenda kompetencave të tij.

QËLLIMET DHE DETYRAT E FAK-ut

Neni 9.

Organizatrat sportive, rajonale apo lokale, klubet atletike bashkohen në Federatën Atletikës të Kosovës për të arritur qëllimet e përbashkëta, përkatësisht:

- Afirmimin dhe promovimin e atletikës në Kosovë
- Përcaktimin e parimeve themelore të zhvillimit dhe drejtimin e zhvillimit të atletikës,
- Koordinimin e veprimeve të përbashkëta në masivizim, zhvillim dhe përparimit kualitativ të sportit të atletikës, si kushte të domosdoshme për arritjen e rezultateve të lartë në lëmin e sportit atletikës,
- Miratimin dhe zbatimin e plan programit afatshkurtër dhe afatgjatë të zhvillimit të atletikës në përgjithësi,
- Ofron ndihmë në përgatitjen e atletëve për të arritur rezultate të larta dhe pjesëmarrje në krijimin e kategorive sportive,
- Bashkëpunim dhe pjesëmarrje në aktivitetet atletike ndërkombëtare në botë, në Evropë dhe Ballkan, në aktivitetet e lëvizjes olimpike dhe në organizatat rajonale sportive ndërkombëtare,
- Organizon pjesëmarrjen e ekipit kombëtar të Kosovës, klubeve dhe individëve në garat ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit.
- Përdorimin e fondeve të zhvillimit dhe fondeve tjera, të organizatave sportive ndërkombëtare, donacionet dhe ndihmat e tjera nga vendi dhe jashtë vendit.
- Respektimin dhe zbatimin e normave, rregullave dhe standardeve ndërkombëtare, si dhe masave për të parandaluar dopingun dhe mbrojtjen në sportin e atletikës,
- Pjesëmarrja në hartimin e Programit Kombëtar të Sportit në mënyrë që të sigurojë fonde për aktivitetet e sportit të atletikës.
- Mbështetje në organizimin e shkollave të atletikës, masivizimin dhe zhvillimin e atletikës në shkolla dhe ligave të atletikës për pionier, në nivel komunal, republikan dhe më gjerë,
- Marrja e masave dhe veprimeve për afirmimin e sportit të atletikës,
- Nxitja e krijimit të klubeve të reja të atletikës,
- Vendosja e sistemit të garave republikane në atletikë dhe forma të tjera të garave atletike, duke u kujdesur për mbajtjen e kampionateve republikane për të gjitha kategoritë si dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së konkursit në organizimin e garave në nivel rajonal dhe ndërkombëtar,
- Nxitja e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së tereneve të atletikës,

- Inkurajon veprimtari botuese në fushën e atletikës, mbledhjen e dokumentacionit, dokumenteve arkivore dhe literaturën historike dhe të dhëna mbi aktivitetet e atletikës, klubeve atletike dhe individëve,
- Studimin për të promovuar atletikën dhe inkurajimin në trajnimin e personelit profesional të atletikës (trajnerëve, gjyqtarëve dhe personave të tjerë puna e të cilëve është e rëndësishme për aktivitetet e atletikës).
- Organizimin e aktiviteteve profesionale (gara sportive, kampe, seminare, diskutimeve profesionale dhe botime, etj.) të karakterit lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.
- Parandalimin e përdorimit të substancave të ndaluara në sport.
- Kryerjen edhe të punëve tjera të përbashkëta në interes të zhvillimit të atletikës, në përputhje me Ligjin dhe me këtë Statut.

Neni 10.

Federata Atletike e Kosovës realizon bashkëpunim në zhvillimin e marrëdhënieve me organizatat ndërkombëtare sportive, në mënyrë të pavarur dhe në kuadër të bashkëpunimit të caktuar në organizatat ndërkombëtare ku është anëtare.

Për realizimin e suksesshëm të detyrave të tyre, arritjen e qëllimeve dhe interesave të përbashkëta, bashkëpunon me organizatat e tjera, institucionet arsimore dhe qeveritë lokale në territorin e Republikës.

ORGANIZIMI I FEDERATËS ATLETIKE

Neni 11.

Anëtarësimi në Federatën Atletike të Kosovës arrihet duke përmbushur kërkesat e Ligjit dhe të këtij Statuti.

Anëtarësimi në FAK është i bazuar mbi aplikimin, duke nënshkruar deklaratën, një anëtar i cili përmbush kërkesat e Ligjit dhe të këtij Statuti, me të cilën vendimin e bie Kryesia të cilën pastaj e verifikon Kuvendi. Nëse aplikuesi i kërkesës nuk i plotëson kushtet atëherë kryesia e FAK-ut do të jap afat 60 ditë anëtarit për të rregulluar dokumentacionin.

Anëtarësimi në FAK shënohet në një regjistër të posaçëm, dhe me këtë lëshohet dokumenti i regjistrimit e pastaj nëse plotëson kushtet edhe licenca për punë. Kryesia mund të parashikojë kuotat e anëtarësimit për anëtarët e Federatës.

Neni 12.

Me statutin e anëtarit – klubit të FAK-ut në mënyrë të përafërt rregullohen: detyrat e organizatës dhe organet e klubit atletik, përfaqësimi, pjesëmarrja, transparencja, mënyra e sigurimit të burimeve financiare, mbrojtja shëndetësore për atlet, të drejtat dhe obligimet e anëtarëve, kushtet për hyrje në klub gjegjësisht klubi, masat anti-doping, përgjegjësitë disiplinore dhe materiale të anëtarëve, dhe çështjet të cilat janë me rëndësi për punë dhe veprim të klubit atletik.

Shoqatat-asociacionet sportive: trajnerët, gjyqtarët, veteranët, si dhe shoqata të tjera veprimtaria e të cilave është e lidhur për sportin e atletikës mund të jenë anëtar të FAK-ut nëse ata dëshirojnë, vendimin për këtë do ta bie kryesia, për çdo kërkesë veç e veç.

Anëtarët e Federatës atletike detyrimisht duhet të kenë statutet e tyre në përputhje me këtë Statut dhe do të veprojnë në përputhje me pikëpamjet dhe me aktet e organeve e trupave të Federatës.

Neni 13.

Personat juridik-fizik të cilët nuk janë anëtarë të FAK-ut nuk mund të marrin pjesë në gara vendore apo ndërkombëtare të organizuara nga FAK-u, kurse klubet atletike joanëtare nuk mund të jenë anëtarë e as përfaqësues të reprezentacionit të federatës.

Organizimi i garave atletike dhe ngjarjeve të tjera në fushën e atletikës në Kosovë duhet të zbatohet në përputhje me Ligjin si dhe këtë Statut, në bazë të vendimit të organit kompetent apo Kryesisë.

TË DREJTAT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E ANËTARËVE

Neni 14.

Anëtarët e Federatës Atletike të Kosovës do të ushtrojnë të drejtat, kryejnë detyrat dhe janë përgjegjës për arritjen e qëllimeve të caktuara në përputhje me Ligjin dhe këtë statut.

Neni 15.

Të drejtat e anëtarëve të FAK-ut janë:

- Hartimi dhe zbatimi i qëllimeve, masave dhe detyrave të cilat janë në funksion të zhvillimit të atletikës në Kosovë, në përputhje me politikën e themeluar në këtë fushë.
- Përmes përfaqësuesve të tyre të marrin pjesë aktivisht në punën dhe në të gjitha organet vendim-marrëse dhe trupat punues të Federatës,
- Përfaqësuesit e tyre të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet dhe trupat punues të Federatës,
- Të marrin pjesë aktive në krijimin e planeve dhe programeve të punës së Federatës,
- Të kenë njohuri mbi punën e FAK-ut, që të deklarojnë për punën e saj dhe të ndërmarrin veprime, të propozojnë dhe të marrin masa për arritjen e qëllimeve, detyrave dhe programeve të Federatës,
- Të marrin pjesë në veprimtari profesionale dhe aktivitete tjera të Federatës dhe të japin kontributin profesional të tyre,
- Të punojnë në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Neni 16.

Obligimet e anëtarëve të FAK-ut janë:

- Të punojnë së bashku për arritjen e qëllimeve dhe detyrave të përcaktuara me këtë Statut, aktet tjera të FAK-ut dhe vendimet e Federatës,
- Të marrin pjesë aktive në sigurimin e realizimit të planeve dhe programeve të miratuara të Federatës dhe obligime tjera me interes për sportin e atletikës në përgjithësi,
- Që në praktikë të aplikojnë dhe të zbatojë vendimet dhe konkluzionet e Federatës,
- Të marrin pjesë në aktivitetet profesionale të Federatës,
- Që si anëtarë të Federatës të punojnë dhe të veprojnë në pajtim me këtë Statut dhe aktet e tjera të FAK-ut,
- Që të zhvillojnë frymën e tyre sportiv dhe vlerat morale tek atletët, stafi i atletikës dhe organizatave atletike në përgjithësi,
- Që vazhdimisht të aplikojnë dhe të respektojnë kodin e sjelljes të anëtarëve të Federatës.
- Që të mbrojnë të drejtat dhe interesat e Federatës dhe reputacionin e Kosovës dhe të sportit të atletikës.

Neni 17.

Mandati i anëtarësisë së anëtarit të FAK-ut ndërpritet:

1. Me ndërprerjen e punës së anëtarit,
2. Në bazë të kërkesës me shkrim të anëtarit,
3. Për mosplotësimin e kushteve të nenit 11. ose të vepruarit në kundërshtim me nenin 16. të këtij Statuti,
4. Për mospjesëmarrjen në asnjë garë në vitin kalendarik të organizuar nga FAK-u.

Vendimin për ndërprerjen e anëtarësisë për shkaqet e përcaktuara në këtë statut, e bie Kryesia e FAK-ut, për të cilën e informon organin kompetent qeveritar për sport, klubin dhe organet tjera.

Neni 18.

Me akte të veçanta të FAK-ut, në bazë të Statutit dhe rregulloreve tjera, rregullohen të gjitha çështjet që lidhen me punën dhe funksionimin e Federatës, kalimi nga një klub në tjetrin apo në federatat tjera dhe propozicionet për gara dhe çështje të tjera mbi këtë bazë.

Neni 19.

Atleti është person i regjistruar për të garuar në një disiplinë të veçantë në klub në emër të cilit merr pjesë në gara dhe ka të drejtë të një pjesëmarrje për klubin atletik – reprezentacionin vetëm në kufi të asaj se si është rregulluar me rregullore dhe propozicione.

Me atlet të nivelit të lartë mendohet për personin i cili në garat e atletikës ka arritur rezultate të larta, të bazuar në kategorizimin e sportistëve, të cilën e përcakton KOK dhe organi përgjegjës shtetërorë në propozim të kryesisë së FAK-ut.

Rregulloret për garat e atletikës në bazë të propozicioneve dhe akteve përkatëse të FAK-ut në mënyrë të obligueshme duhet të përfshihen në dispozitat mbi të drejtën për pjesëmarrje në gara.

Neni 20.

Atletëve u është e ndaluar përdorimi i mjeteve stimulative (dopingut) të palejuara, kurse në garat sportive mund të marrin pjesë personat që janë të shëndetshëm dhe të aftë për garat përkatëse, siç dëshmohet në lejen garuese të atletit ku është vërtetuar gjendja shëndetësore, për të cilën do të bartë përgjegjësi klubi i cili e ka paraqitur për gara.

Pasqyra shëndetësore e atletit duhet të vërtetohet çdo gjashtë muaj.

Neni 21.

Me trajner të atletikës dhe punonjësit e tjerë profesional në sportin e atletikës mendohen personat të cilët janë të përfshirë në veprimtari sportive-garuese të klubeve të atletikës dhe kanë kualifikime adekuate profesionale dhe aftësi për të kryer detyrën e trajnerit të atletikës, për çka duhet të kenë licencë përkatëse, të cilën a jap FAK-u.

Trajnerët me licencën, që kryejnë veprimtari profesionale në klube mund të organizohen në shoqata profesionale.

Neni 22.

Me gjyqtar të atletikës nënkuptohet personi që ka fituar titullin e gjyqtarit me dhënien e provimit dhe marrjen e licencës të lëshuar nga FAK-u.

Në kryerjen e funksioneve të tij, gjyqtari i atletikës është i pavarur dhe gjykon në bazë të rregullave për gara atletike. Gjykimin në gara organizohet dhe kryhet në përputhje me rregullat dhe propozicionet e garave të atletikës në varësi nga niveli dhe lloji i garës.

Gjyqtarët, me licencë, që kryejnë veprimtari profesionale në klube dhe jashtë tyre mund të organizohen në shoqatë profesionale të gjyqtarëve të atletikës.

ORGANET E FEDERATËS ATLETIKE

Neni 23.

Organet e Federatës Atletike janë: Kuvendi, Kryesia dhe Këshilli mbikëqyrës

KUVENDI

Neni 24.

Kuvendi është organi më i lartë qeverisës në punët e Federatës Atletike, e cila në mënyrë transparente planifikon, shqyrton dhe vlerëson aktivitetet dhe zhvillimin e sportit të atletikës në mes të dy seancave.

Kuvendin e përbëjnë nga dy delegat nga secili klub i licencuar i atletikës – anëtar të federatës. Shoqatat e tjera mund të delegojnë një delegat në Kuvend.

Klubet të cilat nuk janë të licencuara në federatën atletike të Kosovës mund të marrin pjesë në kuvend me një përfaqësues, por nuk kanë të drejtë vote.

Neni 25.

Kuvendi mbledhet sipas nevojës.

Kuvendi mbledhet së paku një herë në vit apo kur këtë e kërkon Kryesia, kur këtë e kërkon të paktën 1/3 e klubeve të atletikës apo kur mbledhjen e Kuvendit e kërkon Këshilli Mbikëqyrës.

Seanca e Kuvendit thirret së paku shtatë ditë para ditës të mbajtjes së saj me paraqitjen e rendit të ditës dhe dërgimin e materialeve të propozuara sipas rendit të ditës, duke treguar kohën dhe vendin e mbledhjes.

Nëse seanca e Kuvendit nuk mbahet pas thirrjes së tretë radhazi, Kryesia është përgjegjëse që të organizojë dhe të përgatisë një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit.

Neni 26.

Delegatët e Kuvendit zgjidhen për një mandat prej katër vitesh, me mundësi të rizgjedhjes.

Delegatët e Kuvendit janë përgjegjës për punën e tyre në Kuvend, shoqatës sportive - klubit prej të cilit janë deleguar si anëtarë të saj. Nëse një anëtar i Kuvendit nuk i përmbush detyrimet e tij sipas akteve të Federatës mund të revokohet (shkarkohet) në propozim të Kryesisë ose organizatës sportive që e ka deleguar, me procedurë dhe në mënyrën e përcaktuar për zgjedhjen dhe shkarkimin e delegatëve të Kuvendit.

Neni 27.

Kuvendi i Federatës Atletikës:

- Miraton Statutin dhe aktet tjera ligjore,
- Shqyrton planet dhe programet (vjetore, afatmesëm dhe afatgjatë) e zhvillimit të Federatës Atletike, dhe udhëzimet për punën e organeve të Federatës,
- Shqyrton raportet e Kryesisë dhe Këshillit Mbikëqyrës dhe vendos mbi to,
- Verifikon mandatin e anëtarëve,
- Zgjedh Kryetarin e FAK-ut, nënkryetarin, shtatë anëtarë të kryesisë dhe Këshillin mbikëqyrës.
- Miraton rregulloret e veta procedurale,
- Kryen detyra të tjera, në përputhje me ligjin dhe Statutin.

Neni 28.

Kuvendi mund të diskutojë dhe të marr vendime nëse shumica e anëtarëve të tij marrin pjesë në mbledhje. Vendimet merren me vota të hapura dhe me shumicë votash të anëtarëve prezent, në qoftë se në këtë statut për të marrë një vendim të veçantë nuk është përshkruar me një shumicë të veçantë.

Kuvendi mund të vendosë që një vendim për çështje të caktuara të bëhet me votim të fshehtë. Kryetari kryeson mbledhjet e Kuvendit të FAK-ut, kurse në mungesë apo pamundësi të tij nënkryetari ose një person i caktuar prej tij.

Mënyrën e punës së Kuvendit dhe pyetjet tjera të cilat janë me rëndësi për punën e saj dhe vendimmarrja më afër rregullohen me rregulloren e Kuvendit.

KRYESIA

Neni 29.

Kryesia është organ operativ - ekzekutues i FAK-ut i cili përgatit të gjitha propozimet dhe materialet për Kuvend dhe zbaton politikën në bazë të ligjit dhe të këtij Statuti, udhëzimet dhe aktet e tjera të Kuvendit, qëndrimet dhe vendimet e tyre dhe në pajtim me Ligjin udhëheqë me transaksionet në mes të dy seancave të Kuvendit.

Kryesia FAK-ut përbëhet nga të paktën 7 anëtarë në mandat prej 4 vjetësh, me kusht që i njëjti person mund të rizgjidhet.

Nga përbërja e Bordit, kryetari do të propozojë një nënkryetar.

Neni 30.

Bordi i FAK-ut përveç detyrave të mësipërme:

1. përcakton propozimin e Statutit të FAK-ut dhe propozimet e akteve të përgjithshme të miratuara nga Bordi i FAK-ut dhe Kuvendi i FAK-ut, planin e punës dhe planin financiar të FAK-ut,
2. vendos për themelimin e ndërmarrjeve, institucioneve, agjencive etj. me rëndësi për FAK-un dhe anëtarët e FAK-ut,
3. miraton aktet e përgjithshme të FAK-ut, vendimet të cilat nuk janë në kompetencat e Kuvendit të FAK-ut si vijon:
 - Rregullat dhe propozicionet për gara në Kosovës,
 - Rregullore për kalim të atletit nga klubi në klub,
 - Vendimin mbi shumën e kompensimit në FAK,
 - Rregullore për regjistrimin e atletëve;
 - Rregullore mbi përgjegjësinë Disiplinore në FAK,
 - Rregullore për shpalljen e më të suksesshmëve në FAK,
 - Rregullore për shpërblime në FAK,
 - Rregullore për pranim të rekordit në FAK,
 - Rregullore shëndetësore,
 - Rregullore për masat e parandalimit të përdorimit të dopingut,
 - Rregulloren e punës së Bordit të FAK-ut
 - Dhe akte të tjera në përgjegjësinë e saj.
4. vendos mbi marrjen dhe humbjen e anëtarësisë në FAK,
5. përcakton programin e bashkëpunimit sportiv ndërkombëtar dhe garave ndërkombëtare,
6. miraton kalendarin, shpërblimet dhe zbatimin në garat atletike në FAK,
7. vendosë për vendin e garave ndërkombëtare të organizuara nga FAK-u dhe organizatorin e drejtpërdrejtë të garës,
8. emërton udhëheqësit e reprezentacionit kombëtar të Kosovës për garat ndërkombëtare dhe shqyrton raportet e udhëheqësve për këto gara;

9. emëron dhe shkarkon përfaqësuesit e FAK-ut në KOK dhe në organizatat tjera ndërkombëtare dhe propozon kandidatët për zgjedhjet për organet e organizatave ndërkombëtare atletike;
10. vendos si organ i shkallës së dytë për ankesa kundër vendimeve të shkallës së parë të personave të emëruar FAK-ut;
11. verifikon rekordet atletike të Kosovës,
12. ndan mirënjohjet dhe çmimet e FAK-ut,
13. miraton projektet e zhvillimit dhe ato hulumtuese;
14. kryen edhe punë tjera nga veprimtaria e FAK-ut të cilat nuk janë nën juridiksionin e Kuvendit të FAK-ut.

Për kryerjen e aktiviteteve të caktuara brenda juridiksionit të saj Bordi mund të formojë komisione dhe trupa punues. Vendimi për ngritjen e komisionit, respektivisht organit të punës e përcakton me kompetencat dhe përbërjen e tij.

Përfaqësuesit e Komisionit dhe trupave punuese marrin pjesë në mbledhje të Bordit të FAK-ut, pa të drejtë vote, kur në rendin e ditës ka çështje nga kompetencat e tyre.

Neni 31.

Kryetarin e FAK-ut – Kryesisë e zgjedh Kuvendi.

Nënkryetarin e Parë e Zgjedh Kuvendi i FAK-ut

Bordi i FAK-ut përbëhet 11 anëtarë, prej të cilëve 7 i zgjedhë kuvendi, ndërsa 2 i emëron kryetari. Prej 8 anëtarëve që i zgjedhë kuvendi një prej tyre duhet të jenë e gjinisë femërore dhe një nga minoritetet që jetojnë në Kosovë.

Neni 32.

Seancat e Kryesisë i thirret Kryetari, sipas paraqitjes së nevojës, ndërsa rendin e ditës në konsultim me Sekretarin e Përgjithshëm.

Kryetari i Kryesisë ka obligim të thërras seancën – mbledhje të Kryesisë në kërkesë të Këshillit Mbikëqyrës dhe së paku pesë anëtarëve të Kryesisë.

Neni 33.

Kryetari i Federatës Atletike të Kosovës, në përputhje me Ligjin dhe statutin:

- përfaqëson dhe prezanton FAK-un,
- thërret mbledhjet dhe udhëheqë punën e Kryesisë së FAK-ut,
- kujdeset për realizimin e politikave dhe detyrave me anëtarët e tjerë të Kryesisë së Federatës të cilat mund të jenë përgjegjës në mënyrë individuale për punë të caktuara në fusha të ndryshme të atletikës,
- Kryeson Kuvendin.

Nënkryetarët e Kryesisë ndihmojnë në punën e Kryetarit, e zëvendëson atë në mungesë të tij apo nga pamundësia për ta kryer detyrën.

Kuvendi mund të shkarkojë kryetarin e kryesisë me propozim të shumicës së kryesisë dhe nënkryetarin me propozim të kryetarit të kryesisë, nëse vërteton që nuk po i zbatojnë obligimet, ligjet dhe politikat të cilat i ka miratuar dhe konfirmuar Kuvendi.

Neni 34.

Kryesia mund të merr vendime nëse në mbledhje marrin pjesë shumica e anëtarëve të Kryesisë, kurse vendimet i merr nëse janë prezent shumica e anëtarëve në mbledhje.

Në mbledhjet e Kryesisë mund të marrin pjesë pa të drejtë vote edhe kryetarët e komisioneve dhe organe të tjera punuese apo organizatave tjera.

Neni 35.

Kryesia emëron dhe shkarkon anëtarët e komisioneve dhe organeve tjera, si më poshtë:

- Këshillin profesional për zhvillimin e atletikës nga 5 anëtarë,
- Selektorët për tri kategori,
- Komisionin shëndetësore prej 3 anëtarëve,
- Komisionin e marketingut prej 3 anëtarëve,
- Komisionin disiplinor prej 3 anëtarëve,
- Komisionin e garave prej 3 anëtarëve,
- Komisionin e regjistrimit prej 3 anëtarëve,
- Dhe organet e tjera të punës, sipas nevojës.

Me vendimin për themelimin e Komisionit dhe organeve të tjera punuese përcaktohen detyrat dhe mënyra e punës. Përveç anëtarëve të Kuvendit, në përbërjen e komisioneve apo organeve tjera punuese mund të emërohen edhe punëtor të tjerë të atletikës pjesëmarrja e të cilëve është përfituese dhe e rëndësishme për zbatimin e detyrave programore të Federatës Atletike, me kusht që një person mund të jetë anëtar më së shumti i dy komisioneve apo organeve tjera.

Punën e komisioneve dhe organeve tjera punuese e koordinon sekretari i përgjithshëm i Federatës Atletike, nëse në vendimin për krijimin e organit nuk është thënë ndryshe.

KËSHILLI MBIKQYRËS

Neni 36.

Këshilli Mbikëqyrës kryen kontroll mbi përdorimin e fondeve dhe shqyrtimin e ligjshmërisë së veprimeve dhe të bilancit të Federatës Atletike.

Pasqyra e fondeve të Federatës Atletike kryhet së paku një herë në vit.

Këshilli mbikëqyrës i raporton kuvendit për punën e tij dhe përdorimin e fondeve të Federatës atletike.

Neni 37.

Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi dhe të njëjtit i shkarkon Kuvendi i Federatës Atletike për katër vjet me mundësi rizgjedhje për një mandat tjetër.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Neni 38.

Për të kryer punë profesionale dhe administrativo-teknike Kryesia zgjedhë Sekretarin e Përgjithshëm me rekomandim të Kryetarit të Kryesisë së FAK-ut në periudhë katër vjeçare, i njëjti person mund të rizgjidhet.

Për punën e tij, Sekretari i Përgjithshëm i përgjigjet Kryesisë dhe kryetarit.

Neni 39.

Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Atletike varësisht nga mundësitë dhe kushtet do të jetë në marrëdhënie pune me Federatën Atletike, në këtë rast zgjidhet me konkurs të hapur. Vendimin për këtë, si dhe çështje të tjera që lidhen me Sekretarin e Përgjithshëm i bie Kryesia.

Në rastin e paragrafit të mësipërm arrihet një marrëveshje në të cilin të drejtat dhe detyrimet e përbashkëta më përfaqësohen rregullohen në përputhje me rregulloret në fuqi.

Sekretari i Përgjithshëm i cili nuk është i punësuar nga Federata Atletike, Bordi mund të vendosë tarifa të përkohshme për punën e tij.

Neni 40.

Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Atletike:

- Përfaqëson Federatën Atletike në kuadër të kompetencave të tij,
- Përgatit dhe zbaton planin financiar në përputhje me këtë Statut,
- Kryen veprimtari në përputhje me vendimet përkatëse, konkluzionet dhe masat e Kuvendit dhe të Kryesisë,
- Përgatit dhe merr pjesë në përgatitjen e materialeve për mbledhjet e Kuvendit dhe të Kryesisë,
- Është përgjegjës në menaxhimin e të gjitha punëve rreth administrimit të Federatës Atletike, dokumentacionit, përgatitjes, dërgimit të postës
- Është përgjegjës për shfrytëzimin ligjor të vulave të Federatës Atletike dhe ruajtjen e tyre,
- Është përgjegjës për pronën dhe ligjshmërinë e punës së Federatës Atletike
- Kryen detyra të tjera të cilat ia ka besuar Kryesia e Federatës.

Zbatimin e detyrave nga paragrafi 1. i kryen në marrëveshje me Kryetarin.

REPREZENTACIONI

Neni 41.

Për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare dhe përkatëse formohet reprezentacioni i selektuar i meshkujve dhe femrave të Kosovës në një shumëllojshmëri të moshës në kategori.

Komisioni përzgjedhës do të përcaktojë përbërjen e të gjithë ekipit.

Të gjitha aktivitetet, programet dhe raportet në lidhje me reprezentacionin në propozim të komisionit selektues i miraton Kryesia.

Neni 42.

Federata atletike e Kosovës, kryen kontrollin e dopingut sipas IAAF-së në garë dhe jashtë garës, në varësi të nevojave dhe paraqet raport vjetor për veprimtarinë e saj.

Lejon IAAF-në apo institucioneve të autorizuara të bëjë kontrollin e dopingut në kampionatin kombëtar dhe garat tjera që i zgjedhë, i mundëson, i organizon dhe zbaton.

Lejon IAAF ose institucionet e autorizuara për të kryer kontrollin e dopingut për atletët e tyre jashtë garës.

Neni 43.

Federata Atletike e Kosovës u lejon atletëve e tyre që të përdorin shërbimet e autorizuara agjent - menaxher në përputhje me rregullat e IAAF-së.

FONDET PËR PUNË DHE FINANCIM TË FEDERATËS ATLETIKE

Neni 44.

Federata Atletike menaxhon pronat dhe pasuritë të cilat i posedon apo u janë dhënë në përdorim sipas nevojës.

Në bazë të udhëzimeve, programeve dhe planit vjetor të punës, të ardhurat dhe shpenzimet e federatës atletike janë të përcaktuara në planin financiar.

Neni 45.

Fondet e Federatës Atletike mund të përdoren me qëllim të veçantë dhe në përputhje me programin e punës dhe planin financiar të Federatës Atletike.

Menaxhimi financiar dhe material është i organizuar dhe kryhet në përputhje me Ligjin dhe rregulloret tjera që kanë të bëjnë me këtë çështje, kurse këto punë i kryen personi i kualifikuar.

Të autorizuar për të ekzekutuar dhe të nënshkruar dokumentet financiare janë Kryetari, Nënkryetari, dhe Sekretari i Përgjithshëm i Federatës brenda kompetencave të tyre.

Neni 46.

Për realizimin e detyrave Federata Atletike gjeneron mjete materiale, mallra dhe të drejtat materiale:

- nga kontributet e anëtarëve të saj,
- nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe qeveritë lokale,
- organizimi i ngjarjeve atletike,
- nga transmetimet televizive të ngjarjeve atletike,
- donacionet, grantet, dhurata, dhurimet, trashëgimitë, sponsorët, lokal dhe ndërkombëtar, si dhe reklamat, dividendët mbi fondet e investuara,
- Nga kryerja e veprimtarive në përputhje me Statutin dhe Ligjin,
- Nga burime tjera.

TRANSPARENCA E PUNËS

Neni 47.

Transparenca (Publikimi) e punës së Federatës Atletike dhe organeve të saj do të ushtrohen nga veprimi publik i organeve të Federatës Atletike, me informimin e rregullt të organizatave sportive, organizatave shtetërore, organeve sportive, shoqatave dhe mediave, përmes konferencave për shtyp, deklaratave publike dhe përmes pranisë së drejtpërdrejtë të përfaqësuesve në programet e mediave dhe mbledhjet e organeve të Federatës Atletike.

Detaje më të përafërta të çështjeve nga paragrafi 1 i këtij neni do të përcaktohen me vendim të posaçëm të Kryesisë.

SHPËRBLIMET, NDERIMET DHE MIRËNJOHJET

Neni 48

Për punë të suksesshme dhe rezultate të shkëlqyera në përparimin dhe zhvillimin e sportit të atletikës, kryerje e detyrave me përgjegjësi në fushën e organizimit ose përparimit të sportit të atletikës dhe organizatës atletike, atletët, punëtorët e atletikës, trajnerët, gjyqtarët dhe personat e tjerë fizikë dhe juridikë mund të jenë të lavdëruar (falënderuar) dhe të shpërblehen.

Shpërblimet u jepen anëtarëve të organizatave të atletikës për punë shumëvjeçare të suksesshme në sportin e atletikës.

Çmimet, shpërblimet dhe lëvdatat jepen bazuar në një nga aktet e veçanta nënligjore të Federatës Atletike.

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE

Neni 49.

Ndaj anëtarëve të organizatave atletike – Federatës Atletike, respektivisht individëve të cilët në punën e tyre shkelin dispozitat e Statutit dhe rregulloreve tjera që lidhen me punën e tyre apo nuk i përmbahen parimeve të përgjithshme të sportit, organizatat atletike ndërmerren masa disiplinore.

Fillimin e procedurës, masat disiplinore, kufizimet, dënimet dhe masa e tjera, procedurat dhe metodat e punës së autoriteteve përgjegjëse për vendosjen e masave disiplinore, si dhe çështjet tjera, janë të rregulluara me aktin e përgjithshëm të miratuar nga Kuvendi i Federatës Atletike.

SHPËRBËRJA E FEDERATËS ATLETIKE

Neni 50.

Federata Atletike do të shpërbëhet kur këtë e vendos Kuvendi dhe sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

Vendimi për shpërbërjen e Federatës atletike nga paragrafit 1 këtij neni, e bie Kuvendi me dy të tretat e shumicës të numrit të përgjithshëm të gjithë delegatëve.

Në rast të shpërbërjes, prona e Federatës Atletike i përket autoritetit republikan përgjegjës për sport.

MËNYRA E VENDIMEVE PËR NDRYSHIME DHE PLOTËSIME TË STATUTIT

Neni 51.

Ndryshimet dhe plotësimet në statut bëhen me procedura dhe në mënyrën e përcaktuar për miratimin e tij.

Propozim për ndryshim dhe plotësim të statutit mund të paraqiten nga: kryesia, këshilli mbikëqyrës, 1/3 e delagetëve të Kuvendit.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 52.

Aktet e përgjithshme të Federatës atletike të Kosovës, dhe aktet e anëtarëve të Federatës - klubeve të atletikës duhet t'i harmonizojnë statutet e tyre me këtë statut brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij Statuti.

Neni 53.

Me hyrjen në fuqi të këtij statuti përfundon zbatimi i statutit të Federatës Atletike të Kosovës i vitit 2012.

Neni 54.

Ky statut hyn në fuqi pas aprovimit të tij nga Kuvendi.

Në Prishtinë, 06.02.2016.

KRYETARI I FAK-ut
Kryetari i kuvendit
Halil Sylejmani

